



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data:  
11 Dhjetor 2020

Nr: 7

V E N D I M

PËR  
CAKTIMIN E NUMRIT TË MANDATEVE PËR ÇDO ZONË ZGJEDHORE TË ZGJEDHJEVE PËR  
KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021

Komisioni Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 11.12. 2020, me pjesëmarrjen e:

Ilirjana	NANO -	Kryetare
Arens	ÇELA -	Anëtar
Dritan	ÇAKA -	Anëtar
Helga	VUKAJ -	Anëtare
Muharrem	ÇAKAJ -	Anëtar

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Caktimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

**BAZA LIGJORE:** Neni 20, pika 2, shkronja “b”, neni 74, pika 1, neni 75 dhe neni 76 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Rregullator në zbatim të nenit 20, pika 2, shkronja “b”, nenit 74, paragrafi 1, neni 75 dhe neni 76 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,



Data: 11 Dhjetor 2020

Nr. 7

Caktimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

1

## VËREN

Neni 12, pika 4, e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcakton se Komisioni Rregullator (Rregullatori) është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet.

Neni 20, pika 2, germa “b”, e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se Komisioni Rregullator ka si kompetencë të shqyrtojë dhe miratojë projekt aktin për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore për zgjedhjet në Kuvend, të përgatitur nga administrata e KQZ.

Bazuar në nenin 76, pika 1, të Kodit Zgjedhor, KQZ me shkresë nr. 2117 Prot., datë 25.11.2020 i kërkoi Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, numrin e përgjithshëm të shtetasve dhe numrin e shtetasve për çdo qark, sipas Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresë nr. 8541/1 Prot., datë 27.11.2020 i ka dërguar KQZ-së të dhënat e kërkuara, duke përcaktuar se numri i shtetasve është i datës 27 nëntor 2020.

Neni 76, pika 1 i Kodit Zgjedhor përcakton se “Si rregull 4 muaj para datës së fillimit të periudhës zgjedhore, që i paraprin fundit të mandatit të Kuvendit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me kërkesë të KQZ-së, dërgon numrin e përgjithshëm të shtetasve, si dhe numrin e shtetasve për çdo qark, bazuar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile”.

Ndërsa pika 2 i të njëjtit nen përcakton se “Përllogaritja dhe miratimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore kryhet brenda 15 ditëve nga marrja e të dhënave sipas pikës 1 të këtij neni”.

Nisur nga sa më sipër, të dhënat e marra nga Ministria e Brendshme respektojnë plotësisht kërkesat dhe janë marrë brenda afatit të përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Këto të dhëna i lejojnë KQZ-së të zbatojë detyrimet ligjore që përcakton “Pjesa e V e Kodit Zgjedhor”.

Bazuar në nenin 74, pika 1, të Kodit Zgjedhor, zona zgjedhore për Kuvendin, përputhet me territorin e qarkut.

Bazuar në nenin 75 të Kodit Zgjedhor dhe të dhënave të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, është llogaritur numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore si më poshtë:

Numri total i shtetasve 4544977 (katër milion e pesëqind e dyzet e katër mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë) është pjesëtuar me numrin 140 (njëqind e dyzet) të mandateve të Kuvendit, ku është përcaktuar numri 32464 (tridhjetë e dy mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) si numri mesatar i shtetasve që i takojnë çdo mandati [numri real i dalë nga pjesëtimi është 32464,12 (tridhjetë e dy mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër pikë dymbëdhjetë)]. Numri i shtetasve për çdo zonë zgjedhore është pjesëtuar me numrin mesatar të shtetasve që i takojnë çdo mandati 32464 (tridhjetë e dy mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) shtetas, dhe çdo zone zgjedhore i është caktuar një numër mandatesh, i barabartë me numrin e plotë të përfutur nga ky pjesëtim.

Pas këtij veprimi mbetën pa u shpërndarë edhe 7 mandate për të plotësuar numrin 140.

Në bazë të nenit 75, pika 5, të Kodit Zgjedhor, këto mandate u janë shpërndarë zonave zgjedhore (qarqeve) që kanë mbetjen më të madhe pas presjes dhjetore, të numrit të përfutur nga pjesëtimi i mësipërm. Veprimet e kryera janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:



Data: 11 Dhejtor 2020

Nr. 7

Caktimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021

2

Nr.	Qarku / Zona Zgjedhore	Shtetas 27 Nëntor 2020	Shtetas pjesëtuar me nr. mesatar	Mandate të plota	Mbetja		Mandate nga mbetja	Mandate gjithsej
					Nr.	Shtetas		25 Prill Viti 2021
1	Berat	229202	7,0601	7	0,0601	1951		7
2	Dibër	173774	5,3528	5	0,3528	11453		5
3	Durrës	462202	14,2373	14	0,2373	7703		14
4	Elbasan	447944	13,7981	13	0,7981	25909	+1	14
5	Fier	509350	15,6896	15	0,6896	22387	+1	16
6	Gjirokastrë	147670	4,5487	4	0,5487	17813		4
7	Korçë	349563	10,7677	10	0,7677	24922	+1	11
8	Kukës	110083	3,3909	3	0,3909	12690		3
9	Lezhë	224927	6,9285	6	0,9285	30142	+1	7
10	Shkodër	344446	10,6100	10	0,6100	19803	+1	11
11	Tiranë	1157763	35,6629	35	0,6629	21520	+1	36
12	Vlorë	388.053	11,9533	11	0,9533	30947	+1	12
<b>Totali</b>		<b>4544977</b>						
Nr. mesatar i votave për mandat		<b>32464</b>		<b>133</b>				<b>140</b>

### PËR KËTO ARSYE

Komisioni Rregullator, mbështetur në nenin 12, pika 4, nenin 20, pika 2, germa “b”, nenin 74, pika 1, nenin 75 dhe nenin 76, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### VENDOSI:

1. Të miratojë caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021 si më poshtë:

Qarku Berat – 7 (shtatë) mandate  
 Qarku Dibër – 5 (pesë) mandate  
 Qarku Durrës – 14 (katërbëdhjetë) mandate  
 Qarku Elbasan – 14 (katërbëdhjetë) mandate  
 Qarku Fier – 16 (gjashtëmbëdhjetë) mandate  
 Qarku Gjirokastrë – 4 (katër) mandate  
 Qarku Korçë – 11 (njëmbëdhjetë) mandate  
 Qarku Kukës – 3 (tre) mandate  
 Qarku Lezhë – 7 (shtatë) mandate  
 Qarku Shkodër – 11 (njëmbëdhjetë) mandate  
 Qarku Tiranë – 36 (tridhjetegjashtë) mandate  
 Qarku Vlorë – 12 (dymbëdhjetë) mandate

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.







Data: 11 Dhejtor 2020

Nr. 7

Caktimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021

3

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ.

<b>Iirjana</b>	<b>NANO -</b>	<b>Kryetare</b>	
<b>Arens</b>	<b>ÇELA -</b>	<b>Anëtar</b>	
<b>Dritan</b>	<b>ÇAKA -</b>	<b>Anëtar</b>	
<b>Helga</b>	<b>VUKAJ -</b>	<b>Anëtare</b>	
<b>Muharrem</b>	<b>ÇAKAJ -</b>	<b>Anëtar</b>	